

VENDIM
Nr.449, datë 18.7.2007

PËR PAGAT E PUNONJËSVE CIVILË TË SHËRBIMIT INFORMATIV USHTARAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 9 të ligjit nr.9295, datë 21.10.2004 “Për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj në Shërbimin Informativ Ushtarak”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave, sipas funksioneve organike, për punonjësit civilë të Shërbimit Informativ Ushtarak, të jenë sipas lidhjes nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave sipas funksioneve organike, për punonjësit civilë të Shërbimit Informativ Ushtarak”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit, diplomë për arsimin e lartë (kolona 1) e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë në muaj.

3. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Punonjësit e tjerë civilë të Shërbimit Informativ Ushtarak, që nuk përmenden në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të trajtohen, në pagë, sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, që i bashkëlidhet vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

7. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**Struktura dhe nivelet e pagave sipas funksioneve organike, për punonjësit civile të
Shërbimit Informativ Ushtarak**

	Pozicioni	PAGA INDIVIDUALE			PAGA MUJORE	
		Kateg- oria	Paga e Grupi t (PG)	Shtesa vjetore për Vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualif ikim (SHK)	Shtesa e Pozicioni t (SHP)
Nr.			1	2	3	4
1	Drejtör	II-b	10050	2%	0	84000
2	Zv/drejtör operacional	III-a	10050	2%	0	65000
3	Zv/drejtör mbështetës	III-a	10050	2%	0	65000
4	Shef shërbimi operacional	III-a	10050	2%	0	65000
5	Shef sektori operacional	III-a/1	10050	2%	0	55000
6	Shef sektori mbështetës	III-a/1	10050	2%	0	55000
7	Shef zyre drejtör	III-b	10050	2%	0	49000
8	Shef Përgjegjës zyre operacional	III-b	10050	2%	0	49000
9	Shef Përgjegjës zyre mbështetës	III-b	10050	2%	0	49000
10	Inspektor i Përgjithshëm	III-b	10050	2%	0	49000
11	Këshilltar juridik	III-b	10050	2%	0	49000
12	Analist	IV-a	10050	2%	0	37450
13	Specialist	IV-a	10050	2%	0	37450
14	Inspektor	IV-b	10050	2%	0	25850